

Leka Zogu, karikatura e Simeonit II: forca tretë si kolonë e pestë

Nga Kastriot Myftaraj

Ahmet Zogu nga e majta në të djathtë të politikës shqiptare

Lëvizja politike më monolite në historinë e politikës shqiptare ka qenë dhe është e majta. E majta shqiptare lindi në fillim të viteve '20 të shekullit XX, me Partinë Popullore, që pati një orientim bolshevik. Një prej krerëve të kësaj partie në fillim qe edhe Ahmet Zogu, i cili hyri në politikën shqiptare në radhët e së majtës. Krerët e Partisë Popullore e shihnin Zogun si një person që nga origjina i takonte së djathtës, por që duhej mbajtur pranë për të përçarë të djathtën në bazën e vet sociale dhe për t'i rrëmbyer asaj mbështetës. Pra, e majta e donte Zogun si një puppet strings që do të flakej kur mos t'i nevojitej më.

Zogu pati aftësinë që t'i kuptonte të gjitha këto dhe, duke përfituar nga përçarja e së majtës, mundi të krijonte një bllok mbështetësish dhe të ngjitej kështu në pushtet, në 1922, duke dalë si një forcë e tretë mes dy partive kryesore, asaj Popullore dhe asaj Përparimtare. Kjo shkaktoi një tërmet të vërtetë në politikën shqiptare, duke shkaktuar praktikisht paralizën e dy partive kryesore. Ahmet Zogu përfitoi nga kjo dhe krijoi një lëvizje politike me anë të së cilës i fitoi lehtësisht zgjedhjet e vitit 1923, përballë një të majte të përçarë.

E majta nxori mësim nga disfata e dyfishtë që iu shkaktua si pasojë e përçarjes. E majta u bashkua për ta përmbysur me çdo kusht Zogun dhe krijoi për këtë qëllim një koalicion heterogjen ku bënë pjesë që nga leninistët si Avni Rustemi dhe Fan Noli dhe deri tek nacionalistët si Bajram Curri, Hasan Prishtina, Rexhep Mitrovica, Hoxha Kadriu dhe Bedri Pejani. Strategjia e së majtës, të udhëhequr nga Fan Noli qe që ta përçante të djathtën, duke i shkëputur asaj grupime si një pjesë e nacionalistëve të përmendur më lart të cilët nuk i bashkonte asgjë me të majtën prokomuniste, që ishte internacionaliste dhe kundër idesë së bashkimit nacional.

Tashmë, politika shqiptare u polarizua mes Zogut në pushtet dhe përkrahësve të vet, pra së djathtës, nga njëra anë dhe koalicionit heterogjen të kontrolluar nga e majta, në anën tjetër. Vendosmëria e opozitës së majtë për ta përmbysur Zogun me çdo kusht, bëri që dinamika e konfliktit të shkallëzohej deri në luftë të armatosur, me Revolucionin e Qershorit, në 1924, që përmbysi të djathtën në pushtet.

E majta e ardhur në pushtet në vitin 1924, filloi ta orientonte vendin drejt Bashkimit Sovjetik. Kjo i dha mundësi Zogut që ishte në mërgim, që të faktorizohej menjëherë në mënyrë relevante, si forcë antikomuniste që mund të ndryshonte realitetin e papëlqyeshëm për Perëndimin, që ishte krijuar në Shqipëri. Zogu siguroi mbështetjen diplomatike dhe materiale të Perëndimit dhe me anë të diplomacisë së huaj në Tiranë, përçau të majtën në pushtet dhe siguroi mbështetjen e pjesës jobolshevike të saj për aksionin e vet të pritshëm për përmbysjen e regjimit të Fan Nolit. Kjo bëri që aksioni i armatosur i Zogut në dhjetor 1924 për përmbysjen e regjimit të majtë, ta arrinte lehtësisht suksesin. Zogu suksesin e vet e quajti "Triumfi i Legalitetit", çka donte të thoshte se u rikthye pushteti i ligjshëm i rrëzuar nga rebelimi i qershorit 1924. Duke e shpallur aksionin e vet si një lëvizje antikomuniste, Zogu u identifikua politikisht me të djathtën, pasi në Ballkanin e kohës, ndarja komunist-antikomunist, qe baraz me atë e majtë-e djathtë.

Strategjia politike për përçarjen e frontit kundërshtar në politikën shqiptare u fut më së pari nga e majta, por qe Zogu ai që e kopjoi dhe e zbatoi atë me një efikasitet të madh. E majta që humbi pushtetin në 1924 nxori mësim nga metodat politike të Zogut. Mësimi kryesor qe se që të merrej dhe të mbahej pushteti, duhej të përçahet e djathta, duke luajtur me interesat e

kundërta të përbërësve të saj.

Aleanca fluide e komunistëve dhe zogistëve në Pezë

Në Luftën e Dytë Botërore qe radha e nxënësit që t'i jepte një leksion mësuesit. Komunistët shqiptarë, trashëgimtarë të së majtës të viteve 1920-1924, që kishin krijuar tashmë partinë e tyre, në vitin 1942, krijuan në Pezë Frontin Antifashist Nacional-Çlirimtar, funksioni i vetëm praktik i të cilit, duke përjashtuar atë demagogjik, ishte që të përçahej e djathta dhe që të tërhiqeshin në krah të komunistëve, një pjesë e forcave të djathta. Zogu, i cili me sa duket i kishte fshirë nga kujtesa mësimet e 1924-ës i dha porosi Abaz Kupit, që të bashkohej me Frontin Antifashist Nacional-Çlirimtar të kontrolluar nga PKSH. Kjo çoi në përçarjen e atyre forcave që supozohej të formonin lëvizjen politike të djathtë antikomuniste që do t'i kundërvihej lëvizjes komuniste që në Konferencën e Pezës kishte shpallur hapur aspiratën e saj për të marrë pushtetin.

Aleanca e komunistëve me zogistët në Konferencën e Pezës është precedenti historik i asaj që sot njihet në fjalorin politik shqiptar me termin "aleancë fluide". Me sa duket zogistët hynë në këtë aleancë, duke marrë një premtim nga komunistët se këta do ta mbështesnin kthimin e Zogut si mbret në Shqipëri, në shkëmbim të legalizimit që do t'i bënte ky lëvizjes së tyre pas luftime. Në kalkulimet e zogistëve, komunistët nuk do të lejoheshin nga Perëndimi, jo vetëm që të vinin në pushtet pas luftime, por as të ekzistonin si lëvizje legale, prandaj ata kishin nevojë për mbështetjen e Zogut. Zogistët mendonin se i kishin në dorë komunistët, për shkak se emrat e gjithë krerëve të lartë komunistë që nga Enver Hoxha, Koçi Xoxe etj., qenë në listat e shërbimit sekret të Zogut si agjentë. Në rast se krerët komunistë nuk e mbanin premtimin, zogistët do t'i demaskonin.

Në atë kohë, në pikëpamjen e zogistëve, monarkistët dhe komunistët mund të bashkëpunonin fare mirë në një aleancë fluide kundër armikut të përbashkët që ishte ajo rrymë politike që pak më pas do të krijonte Konferencën e Pezës dhe që ishte antikomuniste dhe republikane, pra armike e të dy palëve. Pra, zogistët mendonin për një aleancë me komunistët të ngjashme me atë që bëri Princi Sihanuk i Kamboxhias pas Luftës së Dytë Botërore. Një indicje që na çon para në zbulimin e këtij kombinimi misterioz është fakti se as në Konferencën e Pezës dhe as në ato të Labinotit në korrik dhe shtator 1943, nuk u zgjodh një kryetar i Frontit, që në hierarkinë e pushtetit që po ngrihej, kishte atributet e kryetarit të shtetit (Në Pezë u zgjodh vetëm kryetari i Këshillit Nacional-Çlirimtar, Kamber Qafmolla, i cili në vitin 1942 qe kuestori i Tiranës). Me sa duket zogistët e kërkonin këtë vend për Ahmet Zogun. Pas të gjitha gjasave pakti ka qenë që Ahmet Zogu të zgjidhej kryetar i Frontit Antifashist Nacional-Çlirimtar. Kompromisi ka qenë që vendi i kryetarit të mbahej vakant, ndërsa zogistët mos ta krijonin një parti të vetën, çka komunistëve u konvenonte shumë, pasi donin të mbeteshin partia e vetme në Front. Aleanca Enver Hoxha-Abaz Kupi, e lidhur në Pezë, qe në fakt aleanca Enver Hoxha-Ahmet Zogu, pasi Abaz Kupi qe vetëm mëkëmbësi i Ahmet Zogut në Shqipëri.

Natyrisht që komunistët shqiptarë, të cilët instruktoheshin në çdo hap nga jugosllavët, i gjenin shumë konvenuese iluzionet e zogistëve. Vajtja në Pezë e Abaz Kupit, mëkëmbësit të Mbretit të mërguar Zog në Shqipëri, si dhe futja e Kupit në kryesinë e Frontit, qe një përparësi e madhe propagandistike, por edhe strategjike për komunistët. Në aspektin propagandistik, duke u bashkuar me zogistët, armiqtë e tyre të betuar në 1924-ën, komunistët u thoshin shqiptarëve se ata nuk synonin pushtetin, por thjesht çlirimin e vendit nga okupatorët dhe se për këtë qëllim suprem, qenë gati që të bënin sakrificat ideologjike.

Në aspektin strategjik, përçarja e së djathtës i dha mundësi udhëheqjes së PKSH, që atë kohë qe praktikisht në kushtet e një lufte civile brenda radhëve të lëvizjes komuniste, që të shmangë luftën në dy fronte, me fraksionet brenda lëvizjes komuniste dhe me forca antikomuniste. Udhëheqja e PKSH pati mundësi të marrë frymë si dhe të ndërmarin spastrimet në radhët e veta, të cilat qenë një kusht i domosdoshëm për të krijuar një lëvizje

komuniste të llojit stalinist, që do të zbatonte manualin kominternist të marrjes së pushtetit me anë të terrorit, të kryejnë pa u trazuar spastrimet staliniste në radhët e veta deri në qershor 1943, duke krijuar një lëvizje shumë të disiplinuar dhe të kontrolluar me “dorë të hekurt” me anë të ideologjisë e dhunës, pra u dha mundësi të kishin një forcë të aftë për të marrë pushtetin. Asnjë prej lëvizjeve antikomuniste në atë kohë në Shqipëri nuk e zotëronte një forcë të tillë. Antikomunistët që krijuan “Ballin Kombëtar” dy muaj pas Konferencës së Pezës, për të përballuar rrezikun komunist, nuk mund të hynin në luftë kundër komunistëve pa përkrahjen e zogistëve. Në rast se zogistët dhe ballistët do të ishin bashkuar që në fillim për të kundërshtuar lëvizjen komuniste, atëherë kjo e fundit do të qe shkatërruar, pasi në 1942 ajo qe shumë e dobët.

Pse u prish aleanca e zogistëve me komunistët

Zogistët qenë në krah të komunistëve së pakut deri në gusht 1943, kur Abaz Kupi qe në radhët e delegacionit të Frontit Nacional-Çlirimtar në Konferencën e Mukjes. Zogistët kanë thënë se ata u prishën me komunistët dhe dolën nga Fronti pasi komunistët prishën Marrëveshjen e Mukjes. Kjo përrallë nuk është e vështirë të hidhet poshtë. Zogistët hynë në Front edhe pse lëvizja politike që formoi Ballin Kombëtar, me të cilin u bë marrëveshja në Mukje, nuk pranoi që të hynte në Frontin e drejtuar nga komunistët, as në Pezë në shtator 1942 dhe as pas krijimit të “Ballit Kombëtar” në nëntor 1942. Ballistët refuzuan të bashkëpunojnë me komunistët, deri në gusht 1943, për shkak se këta të fundit u kërkonin këtyre që të hynin në Front dhe u mohonin bashkëpunimin në nivel partiak.

Komunistët donin që në Front të kishte vetëm një parti, PKSHP që do ta përdorte Frontin si mjet për të marrë pushtetin. Abaz Kupi shkoi në Mukje jo si kryetar i një lëvizjeje monarkiste (ai këtë do ta krijonte vetëm në tetor 1943), por si lejtant i Enver Hoxhës në Frontin e kontrolluar nga PKSHP. Kjo është e vërteta e pamohueshme. Nisur nga zhvillimet e mëvonshme, duket se zogistët nuk e kanë mirëpritur bashkëpunimin e komunistëve me ballistët në Mukje, për shkak se “Balli Kombëtar” qe një grupim në origjinë antizogist. Aleanca zogisto-komuniste u prish vërtet pas Mukjes, por pas të gjitha gjasave, për faktin se komunistët në Konferencën e Dytë të Këshillit Nacional-Çlirimtar, në Labinot, në korrik 1943, ku mori pjesë edhe Abaz Kupi, refuzuan të mbajnë premtimin për zgjedhjen e Zogut si kryetar të Frontit Antifashist Nacional-Çlirimtar.

Sa i përket prishjes të zogistëve me komunistët ka një episod shumë domethënës, që e tregon Myslim Peza në kujtimet e veta. Në librin e vet me kujtime Myslim Peza tregon për takimin e vet të dytë me Abaz Kupin, një vit pas Konferencës së Pezës:

“Mbas një viti u takova me Bazin e Canës në Tapizë. Sa më pa, u rruadh në fytyrë dhe tregoi me gisht stemën që kisha qendisur në xhaketë.

-Ç’ e ke atë yll të kuq mbi shkabë, o Myslim? Vallahi ta kisha pa se mbanit yll të kuq, s’do të kisha pranuar asgjë nga ato që u morën në Pezë.

-Unë edhe në Konferencën e Pezës e kam pasë yllin e kuq në xhaketë, - i thashë. - Nuk e pëti?!

-Jo,- dredhoi dhelpra plakë”. (Myslim Peza: “Kur dhashë besën”, kujtime, Shtëpia Botuese “8 nëntori”, Tiranë 1987, f. 170.)

Abaz Kupi nuk mund të mos e kishte parë yllin e kuq të Myslim Pezës edhe para një viti, në 1942, në Konferencën e Pezës, si dhe yjet e kuq të Enver Hoxhës e delegatëve të tjerë komunistë, por atëherë Bazit i qenë zënë sytë nga premtimet e komunistëve. Tash që komunistët i shkelën premtimet, Bazit iu hapën sytë.

Midis komunistëve dhe zogistëve ekzistoi një paqe e ftohtë deri në maj 1944, kur komunistët e shpallën hapur konfliktin. Në Kongresin e Përmetit, komunistët e deklaruan hapur se do ta kundërshtonin kthimin e Ahmet Zogut në Shqipëri. Menjëherë pas kësaj Enver Hoxha urdhëroi Divizionin I partizan që të kapërcente Shkumbinin, duke pasur si detyrë kryesore shkatërrimin e forcave të Abaz Kupit. Kështu, në verën e vitit 1944, pasi komunistët e patën

shkatërruar praktikisht “Ballin Kombëtar”, ata ndërmorën aksionin për shkatërrimin e zogistëve, tashmë të mbetur vetëm. Pas shkatërrimit të zogistëve, komunistët nuk kishin më përballë asnjë forcë që t’i rivalizonte në luftën për pushtet. Ahmet Zogu dhe Abaz Kupi e paguan kështu të plotë çmimin për aleancën e tyre me komunistët. Ahmet Zogu, që e mbante veten si mjeshër i Realpolitik në Shqipëri, mori një leksion të hidhur në këtë fushë nga komunistët. Mister mbetet se përse edhe pasi të dy palët u futën në konflikt të hapur, Zogu nuk publikoi dokumentat e shërbimit të vet sekret, që komprometonin krerët e lëvizjes komuniste, duke filluar nga Enver Hoxha. Ndoshta Zogun e kanë ndaluar britanikët që ta bëjë këtë gjë, pasi mes tyre dhe sovjetikëve që bërë marrëveshja që të mbështetej lëvizja partizane në Shqipëri.

Leka Zogu ndjek traditën e të atit, të flirtit me komunistët

Me rastin e 60 vjetorit të Konferencës së Pezës, 16 shtator 2004, Leka Zogu lëshoi një mesazh. Leka Zogu e din mirë të vërtetën e Konferencës së Pezës dhe sesi ia punuan Ahmet Zogut atje Miladin Popoviqi dhe Enver Hoxha. Natyrisht që Leka Zogu nuk ka iluzionet e të atit se me ringjalljen e “frymës së Pezës” ai do të bëhet mbret në sensin real të kryetarit të shtetit dhe jo mbret në sensin eufemik që e quajnë sot pasuesit e vet. Ambicjet e tij të sotme janë shumë më të pakta se ato të Ahmet Zogut në 1942. Ndërsa Ahmet Zogu në 1942 donte të merrte përsëri fronin e Shqipërisë, Leka Zogu i ka kufizuar kufijtë e mbretërisë së vet vetëm në pronat e kurorës, mbi të cilat ai ka një të drejtë trashëgimore të dyshimtë, pasi Ahmet Zogu këto prona i ka poseduar me titullin e kryetarit të shtetit shqiptar dhe jo si trashëgimtar i Xhemalit dhe Fatimes. Si i tillë ai ka vetëm livadhet e Burgajetit. Leka Zogu, si trashëgimtar i Ahmet Zogut, vazhdon flirtin me trashëgimtarët e komunistëve. Në politikën shqiptare ka vite që flitet për daljen e një force të tretë, që do t’i jepte fund bipolarizmit të krijuar nga PD dhe PS. Por, në fjalorin politik shqiptar termi “forcë e tretë”, në 10 vitet e fundit ka pasur një prejardhje diversioniste të majtë dhe ka qenë përdorur me kuptimin e një formacioni të ri politik të djathtë, që do t’i jepte fund kontrollit thuajse të plotë të PD mbi elektoratin e së djathtës dhe do të krijonte një të djathtë dypolare përballë një të majte njëpolare, të dominuar nga PS. Kështu do t’i zgjatej jeta pushtetit të së majtës.

Që prej vitit 1996 e deri në vitin 2004 të gjitha nismat për krijimin e forcës së tretë kanë qenë të djathta, duke filluar që nga “E Djathta e Bashkuar”, e krijuar si koalicion partish, e cila u krijua me synimin e vetëm që të peshkonte në ujën e turbullt elektoral shqiptar vota që tradicionalisht i shkonin PD.

Për aq kohë sa E Djathta e Bashkuar ekzistoi, në vitet 1996-2000, i vetmi funksion i saj, praktikisht që ai që t’i jepte të majtës, e cila që e bashkuar në koalicionin “Aleanca për Shtetin”, të drejtën që të thoshte se koalicioni opozitar i kryesuar nga PD përfaqësonte pjesën destruktive të opozitës, duke nënkuptuar se pjesa konstruktive e opozitës që koalicioni “E Djathta e Bashkuar”. Paradoksalisht, por në mënyrë domethënëse, ai formacion politik që supozohej të avanconte më djathtas se PD, u bë një lëvizje e moderuar politike, plotësisht e pranueshme për të majtën.

Leka Zogu, trashëgimtari i Zogut I, mbretit të përmbysur nga italianët në 1939 dhe të ndaluar nga komunistët e Enver Hoxhës për t’u rikthyer në Shqipëri, në Kongresin e Përmetit, në 1944, doli në maj të këtij viti me një nismë politike mjaft ambicioze, të emërtuar “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”. Atëhere u tha se Leka Zogu i Parë që duke imituar homologun e vet bullgar, Simeon II, i cili në vitin 2001, në prag të zgjedhjeve parlamentare në Bullgari, krijoi një lëvizje politike, që konkurroi në zgjedhje dhe fitoi. Por midis Leka Zogut dhe Simeonit II ka dallime esenciale që e bëjnë Lekën I dhe lëvizjen e inicuar prej tij, që të ngjajë me Simeonin II dhe lëvizjen e tij, po aq sa ç’ngjan karikatura me origjinalin.

Ku ndryshon lëvizja e Leka Zogut nga ajo e Simeonit II

Së pari, ekziston një ndryshim i madh midis të dyve sa i përket çështjes së pronave. Simeoni

II i mori pronat e veta me anë të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë të vitit 1998, pra tre vite para se të krijonte lëvizjen e vet politike, të quajtur “Lëvizja Nacionale Simeoni II”. Ndërsa Leka Zogu e krijoi LZHK dhe po hyn në politikë para se t’i kthehen pronat, çka nuk mundet që mos të krijojë dyshimin se lëvizjet politike të Leka Zogut do të kushtëzohen nga qëllimi i vet imperativ për kthimin e pronave, çka do ta çojë atë në pazare me kryeministrin Nano.

Së dyti, Simeoni II kur shpalli lëvizjen e vet në 6 prill 2001, 71 ditë para zgjedhjeve parlamentare të 17 qershorit në Bullgari, në një apel që i drejtoi nacionit bullgar, i bëri me dije qëllimin e vet për të themeluar një lëvizje sipas emrit të vet, për një integritet e moral politik të ri. Për të realizuar këtë Simeoni II zgjodhi njerëz të rinj me reputacion të panjollësor në të kaluarën komuniste dhe gjatë tranzicionit bullgar. Pra, mes retorikës dhe veprimeve të Simeonit II nuk kishte një diskrepancë (mospërputhje), që do ta bënte lëvizjen e tij të pabesueshme. Një politikë e pastër bëhet me njerëz të pastër. Lëvizja e Simeonit II nuk u bë një lavatriçe politike për të larë “të brendshmet” e ndotura të ish-nomenklaturës komuniste dhe tranzicionit bullgar.

Krejt e kundërta ndodh në rastin e Leka Zogut. LZHK po na paraqitet si një lavatriçe politike ku po futen për t’u larë “të brendshmet” e ndotura të ish-nomenklaturës komuniste dhe të tranzicionit shqiptar, për të na u paraqitur si veshje të reja e të pastra të një politike të re. Si koordinator politik të LZHK me ambasadat e huaja në Tiranë, Leka Zogu zgjodhi Sulejman Abazin, ish-zëvendës drejtorin e përgjithshëm të Sigurimit të Shtetit në vitet 1980-1990 dhe ish-shefin e Degës së Punëve të Brendshme (Sigurimit të Shtetit) për Tropojën në vitet ’70. Ky Sulejman Abazi është njëherësh edhe këshilltar i Leka Zogut.

Emri i Sulejman Abazit në vitin 1995 që në një listë me 36 emra të funksionarëve të lartë të regjimit komunist që u publikua nga Forumi i Intelektualëve Shqiptarë në vitin 1995, si njerëz që kanë kryer genocid. Në janar 1996, Sulejman Abazi u arrestua me akuzën e genocidit dhe të krimeve kundër njerëzimit. Ky Sulejman Abazi me sa duket është edhe një lloj tjetër koordinatori. Ai është koordinatori mes LZHK dhe Fatos Nanos, LZHK dhe SHISH. Me ish-numrin dy të Sigurimit të Shtetit në postin kyç të kontaktuesit të LZHK me diplomacinë e huaj, nuk mundet që mos të besohet se LZHK është një krijesë e Fatos Nanos dhe e SHISH. Pse Leka Zogu e ka marrë pranë vetes, në krye të LZHK, një njeri si Sulejman Abazi, të çilin as PS nuk guxon ta marrë në leadership-in e vet? Përgjigjja e kësaj pyetjeje është e thjeshtë. Në mënyrë që të amortizohet përshtypja e keqe që bëjnë brenda dhe jashtë vendit, qenia në leadership-in e PS-së, e njerëzve si Gramoz Ruçi, ish-ministri i fundit i Brendshëm i regjimit komunist, pra shefi i fundit i Sigurimit të Shtetit. Se kur ish-zëvendës drejtori i përgjithshëm i Sigurimit të Shteti gjendet në leadership-in e LZHK, atëherë PS ka të drejtë të thotë se nuk ka kuptim të stigmatizohet ajo si streha politike e funksionarëve të lartë të Sigurimit, pasi këta tashmë gjenden edhe tek një lëvizje me tendencë të djathta dhe monarkiste si LZHK.

Por, Sulejman Abazi nuk është rasti i vetëm. I gjithë ‘entourage’-i i Leka Zogut në LZHK përbëhet nga ish-bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit. Analisti Bedri Blloshmi e shprehte bukur që në titull këtë, në një shkrim të para pak kohësh: “Politika e spiunëve rrethon Oborrin”, ku sillte prova për një prej intelektualëve kryesorë të LZHK se ka bashkëpunuar me Sigurimin e Shtetit.

Leka Zogu nuk mund të bindë njeri se politikën e re të moralshme që pretendon të bëjë lëvizja e tij, do ta bëjë me një njeri si Eduard Ypi, i cili është një prej atyre njerëzve që prishën reputacionin e PD në kohën që ajo që në pushtet, duke marrë të gjitha llojet e posteve, nga ministri tek drejtori i bankës dhe pastaj duke e braktisur “anijen” kur ajo po mbytej për t’u bashkuar me cilëndo lëvizje politike që i ofronte një post. Po ashtu, Leka Zogu nuk mund të bindë njeri se do të bëjë një politikë të re, kur si zëdhënës i LZHK na paraqitet Fluturak Gërmenji, ish-kryeredaktori i revistës “10 korriku” në vitet ’80, pra një funksionar i lartë i propagandës së regjimit komunist. Askush nuk mund ta besojë se politikën e re, Leka Zogu do ta bëjë me Maksim Begenë, ish-nëndrejtorin dhe drejtorin për 25 vite të SMT-së së

Peshkopisë për të cilin duhet pena e adashit të vet, Maksim Gorkit, për të shpjeguar transformimin e tij brenda natës nga republikan në monarkist. Loja politike e LZHK nuk mund të përmirësohet as nga stoli i rezervave që përgatiten të hyjnë në çastet e fundit dhe ku rrinë njerëz si Abdi Baleta.

Së treti, mbiemri i Simeonit II është Saxe-Coburg-Gotha, çka do të thotë se ai ka lidhje gjaku me dinastinë më të famshme europiane, duke përfshirë edhe atë britanike, çka i jep atij një reputacion dhe autoritet në qarqet ndërkombëtare diplomatike dhe financiare, ku njerëzit e këtyre familjeve kanë shumë fuqi. Kështu që premtimet e Simeonit II ngjajnë të besueshme. Ndërsa mbiemri i Lekës I është “Zogolli”, i shndërruar “Zogu” nga Ahmeti në 1928, kur u bë mbret dhe familja Zogu nuk ka asnjë lidhje gjaku me familjet dinastike europiane, ku një njeri me mbiemrin “Zogu” ndoshta do ta pranonin si stallier. Prandaj, pretendimet e Leka Zogut se ai do të përdorë në dobi të Shqipërisë lidhjet që ka me familjet e huaja dinastike, ngjan në rastin më të mirë si një shaka.

Së katërti, Simeoni II është një njeri me dhunti politike, një orator i përkryer dhe një statist i lindur dhe i kultivuar, ndërsa Leka Zogu nuk po arrin as të flasë shqip rrjedhshëm, madje as kur lexon fjalimet e shkruara nga Abdi Baleta.

Së pesti, monarkia në Shqipëri asnjëherë nuk ka pasur atë mbështetje që ka pasur në Bullgari. Në Bullgari monarkia u përmbys pasi vendi u pushtua nga ushtria sovjetike në vitin 1944, ndërsa në Shqipëri qenë komunistët shqiptarë ata që patën aq forcë sa në Kongresin e Përmetit të ndalojnë rikthimin e Zogut në vend dhe të dëbojnë me armë kreun e lëvizjes zogiste në Shqipëri, Abaz Kupin. Në Bullgari, Simeoni II, i cili krijoi një lëvizje politike 71 ditë para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001, arriti që në zgjedhje të merrte 120 nga 240 vendet në parlament.

Leka Zogu në referendumin për monarkinë në 1997, vërtet që fitoi 33.26% të votave, por ai me sa duket nuk e paska deshifruar saktë këtë votë. Shifra prej 33.26% e votave pro monarkisë përbëhet nga 25.82% të votave pro PD, +3.28% e votave të PLL (të siguruar pasi PD i la dy zona të lira), +0.84% të votave të Partisë “Bashkimi Demokrat” (aleate e PD), + 0.84% të votave të Partisë “Bashkimi Social-Demokrat” (aleate e PD) = 30.74%. Diferenca prej 2.52% i takon jo e gjitha Leka Zogut, pasi duhen zbritur 0.26% të aleates së tashme në LZHK, Partisë Konservatore. Pra, Leka Zogu i takojnë vetëm 2.31% të votave që mund të konsiderohen si të fituara personalisht prej tij në referendum. Sot Leka Zogu nuk mund të jetë i sigurt as për këtë shifër, pasi edhe këta zgjedhës e kanë braktisur kur e panë LZHK-në të mbushur me sigurim dhe Leka Zogun që po bashkëpunon qartas me Fatos Nanon. LZHK mund të ketë si mbështetje të sigurt vetëm 2.31% të votave (27270) të fituara nga PLL në zgjedhjet lokale të vitit 2003, por ato janë pak, madje edhe për të kaluar pragun e sotëm elektoral prej 2.5%.

Dështimi i Simeonit II, ogur i keq për Leka Zogun

Simeoni II në zgjedhjet e 17 qershorit 2001 në Bullgari hyri me premtime joshëse. Programi i tij elektoral për zbatimin e të cilit ai kishte vënë një termin prej 800 ditësh, kishte tre pika kryesore. Simeoni II premtoi se do të dyfishonte pagat, se do t’u jepte bullgarëve kredi me interes zero, si dhe se do të luftonte korrupsionin. Gjithashtu ai premtoi të ulte taksat dhe ta çonte deficitin buxhetor në kuotën zero. Me këto premtime ai mori 47% të votave dhe 50% të vendeve në parlament.

Zgjedhjet lokale të 26 tetorit 2003 në Bullgari erdhën saktësisht 800 ditë pasi Simeoni II u bë kryeministër në 17 korrik 2001. Ai nuk kishte realizuar asnjë prej premtimeve të programit të vet 800 ditor. Në tetor 2003 paga mesatare në Bullgari qe 143 euro (163 USD), duke qenë më e ulta mes 12 vendeve lindore që do të pranoheshin në BE në 2004-2007. Zgjedhjet e 206 tetorit 2003 qenë një katastrofë politike për Lëvizjen Nacionale Simeon II. Ajo zbriti nga 47% në 2001, në 10% e votave në 2003. Në këtë zgjedhje Bullgaria u kthye prapë në bipolaritetin e Partisë Socialiste Bullgare (33%) dhe Bashkimit të Forcave Demokratike (21%), që në

zgjedhjet e qershorit 2001 të dyja së bashku kishin marrë më pak vende në parlament (99) se “Lëvizja Nacionale Simeoni II” (120). Kështu, në zgjedhjet e vitit 2003 Bullgaria u kthye prapë tek bipolarizmi i hershëm të cilin Simeoni II pati pretenduar ta prishte me lëvizjen e vet. Një tjetër disfatë e Simeonit II në zgjedhjet e tetorit 2003 qe se në këto zgjedhje morën pjesë vetëm 32% e zgjedhësve. Kur Simeoni II hyri në politikë në vitin 2001, ai u shpreh se një nga synimet e veta ishte që t’i jepte fund abstenimit të pjesës më të madhe të popullsisë në zgjedhje. Simeoni II nuk arriti që t’i bindte bullgarët, së pakut që të shkojnë në votime dhe jo më të votojnë për të.

Dështimi brenda 800 ditësh i Simeonit II në Bullgari, i cili është një politikan shumë më i aftë, karizmatik, me influencë ndërkombëtare dhe me mbështetje të brendshme, sesa Leka Zogu, është një ogur i keq për Leka Zogun dhe lëvizjen e tij politike, LZHK. Leka Zogu po e imiton Simeonin II në çdo gjë, që nga emri dhe natyra e formacionit politik dhe që nga taktika e kreut të tij. Sipas shembullit të Simeonit II, Leka Zogu deklaroi se ai nuk do të kandidojë për deputet në zgjedhjet e ardhshme. Por Simeoni II tashmë ia ka parë të këqijat kësaj taktike, pasi tash që Simeonit II i ka ikur sharmi politik parazgjedhor, po i zihet për të madhe si papërgjegjshmëri dhe përçmim aristokratik ndaj parlamentit, fakti që nuk pranoi të pjesëmarrë në zgjedhje si kandidat për deputet dhe as të hyjë në parlament nga lista proporcionale e lëvizjes së vet. Kur një monark vihet në krye të një lëvizjeje politike në një republikë parlamentare dhe nuk pranon të garojë dhe vetë për deputet, atëhere ky nuk mund të merret ndryshe veç si një përçmim për institucionet e zgjedhura republikane.

Leka Zogu nuk shqetësohet nga dështimi

Simeoni II e kishte seriozisht angazhimin e vet në politikë. Ai kishte një vizion për transformimin e vendit të vet dhe kërkonte mandatin qeverisës për ta realizuar atë. Ai e dinte se kishte një mbështetje të fuqishme tek elektorati për çka nuk qe e pamundshme dhe e habitshme që të fitonte zgjedhjet. Edhe pse nuk arriti që të plotësonte premtimet e veta elektorale hedonike, ai futi një frymë të re në Bullgari, në institucionet dhe gjithë jetën e vendit, duke qenë se ishte i pari shtetar i vendit i formuar në Perëndim, si një biznesmen i suksesshëm dhe si një njeri i salloneve të shoqërisë së lartë ndërkombëtare. Leka Zogu nuk ka asnjë prej këtyre cilësive. Ai është formuar në një oborr gjysmoriental, nuk ka një vizion për të ardhmen e vendit dhe as iluzionin më të vogël se mund të fitojë.

Por Leka Zogu nuk shqetësohet aspak nga dështimi në zgjedhjet e ardhshme. Leka Zogu po hyn në këto zgjedhje vetëm për shkak të detyrimit që ka si prind ndaj djalit të vet për t’i lënë atij një pasuri për ta pasur të ardhmen e siguruar. Leka Zogu u kthye në Shqipëri në vitin 2002 me xhepat bosh dhe shumë shpejt u detyrua të linte dhe vilën e Ekrem Bardhës ku u vendos fillimisht, për shkak se nuk qe në gjendje që të paguante qiranë. Më në fund ai u vendos në vilën e një ish-kryebashkiaku të kohës së PD, të cilën ky i fundit ia ka lëshuar pa qira, por me detyrimin që Leka Zogu t’ia shënojë emrin ndër katër pesë të parët në listën proporcionale të kandidatëve për deputetë të LZHK. Thuhet se Princi Leka i ka shtyrë studimet jashtë shtetit, në Britaninë e Madhe, për shkak se familja ka atje disa detyrime financiare të pashlyera. Deri më tash disa biznesmenë zogistë në diasporë dhe Shqipëri kanë shlyer faturat e shpenzimeve të përditshme të familjes Zogu (Oborrit), por tash edhe ata kanë filluar të mërzhiten.

Në këto rrethana, Leka Zogu vendosi të shkelë premtimin që bëri kur shkeli në Shqipëri në qershor 2002 se nuk do të merret me politikë. Dhe çuditërisht PS nuk u shqetësua fare dhe “ZP” nuk ia kujtoi premtimin e shkelur të vitit 2002, megjithëse në 1997 nuk hezitonte t’i kujtonte as ngjarjet e vitit 1924, nolistët prokomunistë, paraardhësit e socialistëve të sotëm, e patën rrëzuar me armë nga pushteti të atin e Leka Zogut.

Në rast se Nano dhe PS do të qenë shqetësuar vërtet nga dalja e LZHK, atëhere Leka Zogu do të zinte vendin e Berishës, në titujt e mëdhenj sharës të faqes së parë të “Zërit të Popullit”. Por, që në maj kur Leka Zogu doli me nismën e LZHK dhe deri më sot, emri i tij nuk rezultoi të jetë asnjëherë si i sulmuar në titujt e mëdhenj sharës të “Zërit të Popullit”. Ato i rezervohen

si zakonisht Berishës dhe tash edhe Metës. Qëndrimi që mban “ZP” për Leka Zogun është prova e lakmusit për raportin real në të cilin gjendet ai me Nanon, si dhe LZHK me PS-në. Shqiptarët, së pakut ata që shkojnë dhe votojnë, nuk e kanë të vështirë t’i kuptojnë disa gjëra, se ata në këto 14 vite kanë fituar një intuitë politike.

Arsyeja pse Nano dhe PS e trajtojnë me dashamirësi Leka Zogun mund të kuptohet lehtë. Leka Zogu po hyn në politikë si puppet strings i Fatos Nanos. Natyrisht, çdo politikan ka të drejtë të hyjë në zgjedhje në krye të një partie politike, apo lëvizjeje politike, por rrethanat dhe mënyra sesi po hyn Leka Zogu, e bëjnë shumë të dyshimtë veprimin e tij politik. Dalja e Leka Zogut me LZHK nuk është një nismë serioze për të ndryshuar qeverisjen e vendit, ose së paku për të bërë një impakt pozitiv në parlament, por një lëvizje taktike në dobi të Fatos Nanos dhe të PS për të krijuar një të djathtë dypolare, çka krijon një shans për të majtën e kontrolluar nga Nano që të vazhdojë të dominojë.

Leka Zogu po hyn në politikë në kushtet e një gjendjeje të keqe shëndetësore, ndryshe nga Simeoni II që kur hyri në politikë gëzonte një shëndet të mirë që vazhdon ta ruajë edhe sot. Gjendja e keqe shëndetësore të bën që të dyshosh në aftësitë e tij për të drejtuar fushatën dhe aktivitetin e mëtutjeshëm politik të lëvizjes së vet. Daljet e Leka Zogut në publik, i ulur para një tavoline dhe i rrethuar nga qentë, të kujtojnë ato daljet e Enver Hoxhës në fund të viteve ’70 dhe në fillim të viteve ’80, kur shëndeti i diktatorit kishte marrë tatëpjetën dhe kur daljet e tij publike montoheshin në mënyrë teatrale në një sallë ose kopsht, ku ai rrinte ulur para disa personave. Leka Zogu ka nevojë për kura të shtrenjta, të cilat ai sot për sot nuk është në gjendje t’i paguajë.

Veç kësaj Leka Zogu po hyn në politikë në kushtet kur ka detyrime të mëdha financiare ndaj biznesmenëve që po i paguajnë shpenzimet e jetesës dhe të cilët kanë filluar të kërkojnë pagesat. Pra, Leka Zogu ka nevojë të madhe për pare, të cilat me sa duket po a ofron Fatos Nano, si për nevojat familjare, ashtu edhe për ato të lëvizjes së vet politike.

Detyrimet ndaj Nanos Leka Zogu do t’i shpërblejë në monedhë politike, duke luajtur po atë rol si “E Djathta e Bashkuar” në vitet 1997-2000, pra si një opozitë “konstruktive” nga pikëpamja nanoiste në krahasim me PD-në, si dhe kur Nanos t’i duhen vota për të plotësuar kuorumin prej 60% në vitin 2007 për zgjedhjen e Presidentit të Republikës.

LZHK - kolona e pestë e së majtës tek e djathta

LZHK është sot praktikisht një aleate e PS dhe kjo do të bëhet edhe më e qartë në zgjedhjet e ardhshme kur do të shohim se PS në disa zona elektorale si në Mat, apo në krahina të tjera ku nuk ka shpresë për fitore, sidomos në kushtet e zgjedhjeve me një tur, do të mbështesë LZHK për t’ia rrëmbyer këto zona PD. Nano, duke nxitur krijimin e LZHK dhe duke e mbështetur atë, jo vetëm llogarit që të kundërbalancojë avantazhin praktik që pati PD nga dalja e LSI, por edhe të sigurojë një avantazh më të madh në dobi të PS, duke e rritur artificialisht me anë të mekanizmave elektorale Celibashi-Subashi rezultatin që do të arrijë LZHK në zgjedhje, si dhe duke e ulur artificialisht atë të LSI.

Përfundimisht mund të thuhet se impakti faktik i LZHK në politikën shqiptare nuk është ai i forcës së tretë siç pretendon Leka Zogu dhe përkrahësit e vet, por ai i kolonës së pestë nanoiste brenda së djathtës. Leka Zogu po u paraqitet shqiptarëve si një karikaturë politike e Simeonit II. Ndoshta do të ketë shqiptarë me bindje të djathta, që do të mashtrohen nga retorika e Leka Zogut dhe do të votojnë për të, duke shpresuar se ai përbën një alternativë ndryshe dhe se do të ndërtojë një shtet si ai i Ahmet Zogut, ku nuk ka kriminalitet dhe korrupsion, ku respektohet prona private, një shtet me pasaportën e të cilit shqiptarët mund të udhëtojnë lirisht nëpër botë ku të duan. Në të vërtetë këta njerëz nuk do të votojnë për një alternativë reale, por për një iluzion dhe për më tepër për një iluzion që nuk e ka as njeriu për të cilin ata po votojnë.

Edhe sikur Ahmet Zogu të qe gjallë dhe të vinte në krye të LZHK, ai nuk do të mund të bënte sot ato që bëri në vitet 1922-1939 dhe kjo për shumë arsye dhe në radhë të parë për shkak të

qendrimit të ndryshëm të faktorit ndërkombëtar në raport me Shqipërinë në të dy epokat. Atëherë Britania e Madhe e cila ishte Fuqia e Madhe që dominonte sistemin e Versajës, ia la Shqipërinë një Italie, që ishte e prirur ta ndërtonte shtetin shqiptar dhe t'i siguronte një nivel të kënaqshëm prosperimi ekonomik për ta pasur si një bastion të vetin në Ballkan. Ndërsa sot, SHBA-të që dominojnë botën e pas Luftës së Ftohtë ia kanë lënë në dorë Shqipërinë një Greqie, e cila thjesht kërkon që ta shfrytëzojë atë në stilin më të keq kolonial të shekullit XIX. Praktikisht sot vota për LZHK do të thotë një votë për familjen Zogu, në mënyrë që kjo familje të zgjidhë problemet e veta ekonomike. Natyrisht që LZHK, pasi të sigurojë disa vende në parlament, do të bëjë atje një retorikë të madhe, por këto do të mbeten fjalë dhe vetëm fjalë, madje fjalë të llojit më të keq, pasi janë fjalë të blera me parat e së majtës. Ndoshta LZHK do të arrijë që me asistencën e Celibashit, që do të veprojë sipas urdhrave të Nanos, të marrë një numër deputetësh, nga lista proporcionale, ose edhe drejtpërdrejt në ndonjë zonë, por kjo do t'ia heqë përfundimisht gjethen e fikut kësaj lëvizjeje, pasi, duke konsideruar sesi po bëhen pazaret e sotme politike në LZHK, kjo e fundit do të ketë një grup parlamentar që mund të konsiderohet si Grupi Parlamentar i Sigurimit të Shtetit në parlament, pasi atje ish-zëvendës drejtori i Sigurimit të Shtetit (Sulejman Abazi), që ndoshta do të bëhet kryetar i grupit parlamentar do të ketë në krah Abdi Baletën, Eduard Ypin etj.. Atëherë do ta kuptojnë shqiptarët se deri ku arrin ndyrësia në politikën shqiptare. Natyrisht që, njerëzit që shkojnë pas Leka Zogut në krye të LZHK, publikisht apo incognito për momentin, si Sulejman Abazi, Abdi Baleta, Eduard Ypi etj., nuk kanë ndërmend aspak që të luajnë për interesat e familjes Zogu. Ata luajnë për interesat e veta, sepse shpresojnë që të bëhen deputetë dhe të vazhdojnë të kryejnë misionet e veta përkundër shpërblimit. Në rast se do të definohej LZHK nisur nga njerëzit që e përbëjnë atë, ajo do të mund të etiketohej pa frikë se ekzagjerohet, si një formacion-politik i llojit sigurimso-islamistik, një kombinim i çuditshëm dhe domethënës ky. Në këtë lëvizje njerëzit e Sigurimit të Shtetit gjenden me shumicë, që nga funksionarët e deri tek bashkëpunëtorët. Ndërsa fakti që Leka Zogu dhe i biri i tij janë besimtarë muslimanë praktikantë, gjë që u pa qartas në ceremonitë e varrimit të familjarëve të tyre, si dhe fakti që ideologu dhe shkruesi i fjalimeve të Leka Zogut dhe i programit të LZHK, Abdi Baleta, është kampion i islamizmit në politikën shqiptare, i jep LZHK-së ngjyrën e një lëvizjeje politike islamike.

Botuar tek temaA